



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**  
GMS/EMP

Lënda: Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2023.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, ”, Udhëzimit plotësues të Ministrit së Financave nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit” ose KDIMDP), ka kryer monitorimin e buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2023, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara.

Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Vizioni i Zyrës së Komisionerit është promovimi i një shoqërie që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Misioni ynë është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave në epokën digjitale duke nxitur autoritetet publike dhe kontrolluesit publik e privat në ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2023 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- Pasja e rolit aktiv në përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit ligjor/nënligjor për të dy fushat e veprimtarisë;
- Bashkëpunimi në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e përgjegjësisë si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e tij;

- Thellimi i mbikëqyrjes dhe monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke patur si qëllim rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike si dhe garantimin e aksesit në informacion publik;
- Verifikimi dhe mbikëqyrja e transparencës proaktive të autoriteteve publike, mbi zbatimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- Shtrirja e instalimit të REKPDIT në sa më shumë autoritete publike, si dhe mundësimi i ndërthurjes së tij me shërbimet që ofrohen nga AMS/e-Albania, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Shtimi i burimeve njerëzore dhe financiare për forcimin e kapaciteteve administrative në kuadër të harmonizimit integral të legjislacionit në të dy fushat e përgjegjësisë;
- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), si detyrime specifike që burojnë nga legjislacioni i përmirësuar;
- Komunikimi proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së transparencës, forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim dhe trajnimi periodik i koordinatorëve për të drejtën e informimit veçanërisht për trajtimin e çështjeve me interes publik në balancë me kufizimet për dhënien e informacionit;
- Nxitja e qasjes së re të kontrolluesve/përpunuesve përsa i përket garantimit efektiv të sigurisë së informacionit (SMSI) në proceset përpunuese;
- Roli aktiv në zgjerimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- Programimi i masave në kuadër të zhvillimit të edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit në Tiranë më 2024;
- Roli aktiv në kuadër të organizmave ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është pjesë si dhe me autoritetet homologe në të dy fushat e përgjegjësisë;
- Aplikimi për përfitimin e projekteve nga programe të asistencës nga fondet IPA të BE dhe/ose donatorë të tjerë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, Zyra e Komisionerit është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Zyra e Komisionerit vijon të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen dhe plotësimin e PBA-së por edhe të moduleve të tjera në sistemin AFMIS, deri në marrjen e masave për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS, sipas rekomandimeve të dhëna nga KDIMDP. Në funksion të zbatimit të rekomandimit të Zyrës së Komisionerit lidhur me këtë sistem, do të shihet edhe mundësia e plotësimin të moduleve dhe gjenerimin e formateve më pas. Në raportimet periodike por edhe në cdo korrespondencë që ka patur lidhje me përditësimin e të dhënave në AFMIS, kemi arsyetuar në mënyrë të përsëritur se ky veprim vjen në kundërshtim me legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga ana e MF ende nuk është kryer asnjë veprim në këtë drejtim, gjë e cila mund të sjellë ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenin 30, të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Zyra e Komisionerit, edhe pse nuk është përfshirë në modulën e monitorimit në AFMIS ka përgatitur raportimin dhe vlerësimin e treguesve të performancës të synuar me

treguesit faktik të realizuar, në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 14, datë 30.05.2023 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njesite e qeverisjes Qendrore”.

Për Zyrën e Komisionerit është miratuar vetëm një program buxhetor, “Planifikim, menaxhim, administrim”, buxheti i së cilës konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të zyrës, në drejtim të monitorimit të ligjeve respektive, për arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Produkti i vetëm i Programit 0110, është **Mbikëqyrje/inspektime të kryera & ankesa të trajtuara**, ku parashikimi është **nr. 1830 veprime**

### **E drejta e informimit :**

#### ➤ **Autoritetet Publike me programe dhe transparencë të plotë**

Sigurimi i Transparencës së veprimtarisë së Autoriteteve Publike, nëpërmjet realizimit të proceseve të monitorimit/mbikëqyrjes së elementëve të ndryshëm të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, të autoriteteve publike, të cilat kanë hartuar dhe/ose përditësuar programin e transparencës, forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, përditësimi në regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, seancave dëgjimore dhe dhënien e rekomandimeve e vendimeve.

#### ➤ **Trajtim i ankesave brenda afateve dhe (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave).**

Ankesa të trajtuara në kuadër të parashikimeve të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” si dhe Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, hetime të kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendime të dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

#### ➤ **Mbikëqyrje dhe inspektime.**

Nëpërmjet procedurave për realizimin e këtij produkti do të bëhet e mundur minimizimi i rrezikut të cënimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; Ndërgjegjësimi dhe disiplinimi i kontrolluesve; Krijimi i praktikës së mirë për kontrolluesit.

#### ➤ **Ankesa të trajtuara**

Trajtimi në kohë i ankesave të ardhura nga subjektet e të dhënave personale, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale. Për zgjidhjen dhe trajtimin e ankesave ndiqen hapa procedurale si kontaktimi i vazhdueshëm me subjektin mbi paraqitjen e provave, kërkesë informacioni paraprake nga kontrolluesi, seanca dëgjimore të zhvilluara

deri në zgjidhjen përfundimtare dhe vendimet e dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e kontrolluesve publik e privat

Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin e buxhetit për vitin 2023, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KDIMDP-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në vijimësi dhe strukturat respektive të KDIMDP-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen e vazhdueshme të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KDIMDP-së të përfshirë në Strategjinë Institucionale 2022-2025.

### **1. Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiar**

Zyra e Komisionerit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe efijensë.

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”, fondet e akorduara për funksionimin normal institucional në total u miratuan në vlerën 98.580.000 lekë (përfshirë fondin e vecantë). Në zbatim të Vendimit nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagës dhe niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve Prefektit, Nënprefektit, Nëpuësve Civilë dhe Nëpunësve në disa institucione të Administratës Publike”, si dhe akteve të tjera të MFE (shtesa apo pakësime), buxheti i alokuar për vitin 2023 arriti vlerën 110.322.000 lekë

Në zbatim të këtij buxheti si dhe realizimit dhe finalizimit të procedurave të prokurimit u ndërmoren masa konkrete, duke rishikuar me prioritet dhe orientuar shpenzimet buxhetore drejt aktiviteteve kryesore të institucionit, në respektim të parimeve dhe rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i alokuar për vitin 2023, me ndryshimet gjatë vitit, u shpenzuan **108.335.233** (lekë), ose **98** %, kundrejt planit vjetor 2023. Tabela pasqyron realizimin në vlerë per çdo kategori shpenzimesh përkundrejt totalit të buxhetit të akorduar.

<b>Llog. Ekonomi ke</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Plani i buxhetit viti 2023 (në mijë lekë)</b>	<b>Plani i rishikuar buxhetit viti 2023 (në mijë lekë)</b>	<b>Realizimi i buxhetit viti 2023 (në mijë lekë)</b>
---------------------------------	-------------------	--	--	--

<b>600</b>	Fond Page	62.140.000	70.382.000	70.176.830
<b>601</b>	Kontributi për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	12.630.000	11.130.000	11.014.265
<b>602</b>	Mallra dhe shërbime të tjera	17.220.000	22.220.000	20.737.658
<b>605</b>	Transferta korente jashtë vendit	100.000	100.000	66.480
<b>606</b>	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	490.000	490.000	340.000
<b>230-231</b>	Shpenzime kapitale Blerje pajisje zyre dhe elektronike	6.000.000	6.000.000	6.000.000
	<b>T o t a l i</b>	<b>98.580.000</b>	<b>110.322.000</b>	<b>108.335.233</b>
	<i>Në % kundrejt totalit</i>			<b>98 %</b>

Sic edhe vihet re, kemi nje realizim/përdorim të fondeve buxhetore në masën 98 %.

Ndërkohë në respektim të nenit 38 të Ligjit nr. 9887/2008 “ Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, buxheti i Zyrës së Komisionerit financohet edhe nëpërmjet donacioneve, të cilët nuk paraqesin konflikt interesi. Vlera e mbartur nga viti 2022, sipas artikujve buxhetore, me burim financimi donacionet paraqitet për sa e si më poshtë:

- 1- Shpenzime operative në vlerën 6.479.570 lekë;
- 2- Shpenzime kapitale në vlerën 24.331.671 lekë.

Një pjesë e tyre janë përdorur për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, në vlerën 6.691.552 lekë (përfshirë ngurtësimin e garancisë së punimeve), ndërsa është përdorur fondi në shpenzime të Grupartikulli 602-606 në vlerën prej 2.900.000 lekë.

Në vijim në mënyrë të detajuar informojmë për secilin grup shpenzimesh

- o **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore.**

Grupartikulli 600-601 është realizuar në vlerën 81.191.095 lekë ose 99 %.

Për Zyrën e Komisionerit është akorduar Fondi i Veçantë me vlerë 250 (mijë lekë), i cili referuar akteve administrative është përdorur për mbështetje të punonjësve në raste fatkeqësie, sëmundje apo ndihma të menjëhershme, në masën 100 (mijë lekë) ose rreth 40 %.

Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në strukturë dhe jashtë saj.

Struktura dhe organigrama e kësaj Zyre, ka ndryshuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 24/2023 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, me 60 punonjës. Kuadri i modernizuar ligjor për të dy fushat e përgjegjësisë shtoi kompetencat dhe funksionet mbikëqyrëse, çka solli si domosdoshmëri shtimin e kapaciteteve administrative për përmbushjen e tyre, si në terma sasiorë ashtu edhe cilësorë. Me Aktin Normativ nr. 12/2022 dhe Ligjin e Buxhetit të vitit 2023, u miratua shtesa prej 8 nëpunësish, e cila u reflektua me vendimmarrjen përkatëse të Kuvendit gjatë vitit 2023, edhe përtej këtij numri. Aktualisht numri efektiv i punonjësve për të cilën Zyra e Komisionerit ndërrmorri plotësimin e vendeve vakante për numrin e miratuar gjatë vitit 2023, 52 punonjës, ndërsa struktura dhe organika në zbatim të Vendimit të Kuvendit të cilësuar më lart, u reflektua me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, prej 60 punonjës.

○ **Fondi për Shpenzime Korente të tjera (602-606),**

Grupartikulli 602-606 për periudhën Janar-Dhjetor 2023, është realizuar në vlerën **21.144.138 lekë** ose 93.3 %.

Ky mosrealizim ka ardhur si rrjedhojë i rezultateve pozitive të procedurave të prokurimi.

Ky fond është realizuar për:

- Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
- Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Komisionerit, ku për platformat e instaluara janë ndërmarrë procedurat e mirëmbajtjes vjetore të tyre
- Shpenzime për sigurimin e godinave e të mjeteve të transportit si dhe shërbime të dezinfektimit në situatën covid-19
- Shpenzime të tjera mirëmbajtje/furnizime, e të tjera shërbime bazë të funksionimit
- Në infrastrukturën informatike të KDIMDP-së, janë implementuar sisteme/platforma/ software të ndryshme për mbrojtjen e komunikimit elektronik (e-maile) apo komunikimin me jashtë ( REKPDI/pyetshtetin.al) të cilat funksionojnë nën një licencë dhe mirëmbajtje rutinë periodike vjetore. Prokurimi i rinovimit të licencave dhe update-ve i ka shërbyer KDIMDP-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të saj
- Shpenzime administrative për mbulimin financiar të aktiviteteve të shtuara, si rezultat i funksioneve dhe kompetencave shtesë të Zyrës së Komisionerit, por edhe për shkak të rëndësisë dhe intensitetit të takimeve jashtë vendit në kuadër të procesit të integritetit evropian.

- Shpenzimet për mbulimin e një pjese të shpenzimeve paraprake të organizimit të Konferencës së XV Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, e cila do të mbahet në data 3-5 qershor 2024, Tiranë. Ky është aktiviteti më i rëndësishëm botëror për nxitjen e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe do të shërbejë si një platformë për trajtimin e pikëpamjeve, sfidave dhe mundësive me partnerët e saj, me përfaqësues të botës akademike

Gjatë kësaj periudhe raportimi janë zhvilluar 43 procedura prokurimi të gjitha të sukseshme me fitues dhe plotësim kërkesash.

**Fondi për shpenzime investime (zëri 231)**, me ligjin nr. 84/2022“ Për Buxhetin e vitit 2023” , Zyrës së Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i është alokuar fondi i investimeve, përfshirë rialokimet e brendshme si më poshtë

- Në projektin M890008 “Blerje Softe/sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave”, në vlerën 5.400.000 lekë.
- Në projektin 18AD102 “Blerje pajisje zyre&Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumenta”, në vlerën 600.000 lekë.

Mbi bazën e këtij fondi, Zyra e KDIMDP ka realizuar hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, ndërsa ka përfunduar me sukses edhe procesin e prokurimit elektronik, për të cilën është lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues në vlerën e investimit 5.400.000 lekë me tvsh, çka do të thotë se është realizuar plotësisht si projekt

Si rezultat i përfitimeve financiare nga procesi i prokurimit, në kodin e projektit M890008 “Blerje Softe/sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave”, Zyra e Komisionerit kërkoi pranë MFE mundësinë e miratimit të rialokimit në projektin, me kod 18AD102 “Blerje pajisje zyre&Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumenta”, në vlerën 600.000 lekë, për plotësimin me sete pune bazë të stafit të ri (tavolina, karrige, pc etj), në vijueshmërinë normale të punës. Edhe për këtë projekt pas ndjekjes së procedurës së prokurimit, fondi u ezaurua plotësisht, duke përbushur qëllimin e sigurimit të mobiljeve të reja për stafin e pritshëm në ambientet *open space*.

Në vlerë totale rezulton që fondi i investimeve është realizuar në masën 100 %.

**Në Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për vitin 2023.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është kryer nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. Produktet kryesore janë:

**Nënprodukti A: Trajtim i ankesave brenda afateve** (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave (i ndryshuar), rreth 1100+-)

Zyra e Komisionerit ka realizuar monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke shqyrtuar jo vetëm ankesat e depozituara, por duke kryer gjithashtu inspektime, seanca dëgjimore si dhe duke marrë vendime urdhërimi apo sanksionimi sipas ligjit për rastet kur është konstatuar refuzim i padrejtë i vënies në dispozicion të informacionit.

Zyra e Komisionerit konstaton, se edhe gjatë 2023, ka qëndrueshmëri të numrit të ankesave krahasuar me vitin e kaluar por me një tendencë në rënie, ku në total autoriteti administroi **957 ankesa**, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të **48 procedurave të mbartura nga viti 2022 (gjithsej 1005 ankesa)**. Nga totali prej 1005 ankesash, për 606 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit. Ky është tregues pozitiv ku mbi 60 % e ankesave është dhënë zgjidhje dhe qytetari ka marrë dhe përfituar të drejtën e tij

Si pjesë e procesit të shqyrtimit administrativ për ankesat e depozituara, u zhvilluan 30 inspektime pranë autoriteteve publike dhe 45 seanca dëgjimore.

Zyra e Komisionerit është shprehur me 46 vendime për 47 ankesa.

Nga këto vendime, janë dhënë 42 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 3 vendime rrëzimi, dhe 1 vendim me sanksion administrativ.

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Ky është një tregues cilësor i veprimitarisë së Zyrës së Komisionerit, ku qytetari merr atë çfarë kërkon dhe i nevojitet.

**Në tërësi Nënprodukti A: 1005+30 (ankesa+inspektime)** realizuar mbi 94 % të pritshmërisë.

**Nënprodukti B- Monitorim i Autoriteteve Publike me programe transparencë (332+-monitorime) .**

Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit në kuadër të detyrave dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, ka vijuar monitorimin e programeve të transparencës të publikuar në faqen zyrtare të të gjitha autoriteteve publike, si dhe monitorimin e publikimit dhe përditësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Monitorimi përfshin të gjitha autoritetet publike të pushtetit qendror përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e varësisë, sistemin e drejtësisë, pushtetin lokal si dhe institucione të tjera si shoqëri aksionere ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, IAL-ve si dhe urdhrat profesional. Gjatë vitit 2023 ka pasur një ndryshim të numrit të autoriteteve publike, duke u reduktuar krahasur me një vit më parë, për shkak të ristrukturimit të një pjese prej tyre e veçanërisht të sistemit të gjykatave dhe prokurorive.



Në total gjatë vitit 2023 janë monitoruar **332 autoritete publike** ku rezulton se të gjitha kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit dhe të dhënat e koordinatorëve janë përditësuar dhe në portalin pyetshtetin.al, 306 autoritete publike kanë publikuar programin e transparencës dhe përditësuar me informacion ndërsa regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është përditësuar nga 329 koordinator për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit përveç kryerjes së monitorimeve online, ka zhvilluar gjithashtu edhe inspektime pranë këtyre institucioneve publike (kryesisht pranë institucioneve të varësisë të pushtetit qendror dhe institucione të pavarura). Konkretisht, gjatë këtij viti janë zhvilluar **33 inspektime** me objekt “Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të Autoritetit Publik”:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka miratuar modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

**Nënprodukti B: Janë monitoruar 332 AP, ndërsa janë kryer edhe 33 hetime administrative.** Është një tregues mjaft pozitiv

➤ **Të tjera aktivitete në funksion të rritjes së transparencës**

❖ **Kërkesa nëpërmjet regjistrimit**

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI), i integruar në këtë instrument sipas VKM-së nr. 145/2018, mundëson ushtrimin e së drejtës për informim me kërkesë dhe eventualisht të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Kjo mënyrë siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë të koordinatorit dhe garanton gjurmueshmërinë e procesit, duke mos lënë hapësira për abuzim dhe/ose shmangie të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Në vitin 2023 u realizua instalimi i REKPDI në 27 autoritete të reja, duke e çuar në 222 numrin e AP-ve, nga 195 që kjo shifër ishte në fund të 2022. Janë zhvilluar paralelisht trajnime të rregullta me koordinatorët për mënyrën e përdorimit të tij.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n ka vijuar punën për mirëmbajtjen e shërbimit të kërkesës për informacion nëpërmjet e-albania. Ky sistem është funksional për 163 autoritete publike dhe i vjen në ndihmë qytetarëve për të marrë informacione me karakter publik nëpërmjet kanalit unik qeveritar.

**Aktivitete të tjera mbështetëse.**

**Aktivitete të tjera mbështetëse.**

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus nxitjen e transparencës dhe llogaridhënien e autoriteteve publike është pjesë e :

- ✓ Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP) 2024-2030 dhe Plani i Aktiviteteve
- ✓ Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2024-2030 (SNKK)
- ✓

- ✓ Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023 ( SELP ) ;
- ✓ Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (AKDF) dhe Plani i Veprimit 2021-2026
- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 (SKZHIE)
- ✓
- ✓ Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur (SNDM) dhe Plani i Veprimit 2022-2026
- ✓ Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, dhe Plani i Veprimit
- ✓ Strategjia Kombëtare e Migracionit 2024-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2024-2026

Për secilën nga këto strategji, Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj periodik. Është dhënë kontribut mbi komponentët e asistencës teknike të përfituar në kuadër të IPA *Good Governance* 2020 “Për mirëqeverisjen”, në përgatitjen e pyetësorit e Këshillit të Evropës për Konventën 205/2009 “Mbi aksesin në dokumente zyrtare”, si dhe në plotësimin e pyetësorit të Bankës Botërore për të cilat janë kërkuar të dhëna lidhur me aksesin në informacion dhe parashikimet e ligjit për LDI. .

Zyra e Komisionerit për vitin 2023 ka publikuar cdo muaj newsletter –in “E drejta për informim”.

Gjatë periudhës së raportimit, Zyra e Komisionerit ka vijuar me angazhimin dhe kontributin e saj në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar ku ka marrë pjesë në 6 takime *online* të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në cilësinë e anëtarit që prej vitit 2021. Zyra e KDIMDP ka marrë pjesë aktive në disa takime të grupeve të punës të ICIC ku merr pjesë në cilësinë e anëtarit (Komiteti i Planifikimit të Konferencës ICIC). Në takimet e realizuara janë trajtuar çështje të ndryshme mbi ecurinë e planit strategjik të ICIC dhe është raportuar mbi punën e 4 grupeve të punës, ku Zyra e Komisionerit është pjesë e “Grupit Ndërkombëtar të Punës mbi Transparencën Proaktive dhe Grupin Ndërkombëtar të Punës mbi Trajnimet”.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka nisur përgatitjet për organizimin e Edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, i cili do të zhvillohet në Tiranë, në datat 3 – 5 qershor 2024. Konferenca përbëhet nga Sesioni i Hapur ku marrin pjesë anëtarët e ICIC, përfaqësues nga shoqëria civile dhe media, organizata ndërkombëtare që promovojnë të drejtën e aksesit në informacion, etj. Sesioni i Mbyllur i Konferencës zhvillohet me pjesëmarrje vetëm të anëtarësisë së ICIC.

Në kuadër të 28 shtatorit “Ditës për të Drejtën e Informimit”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, organizuan një aktivitet për të nxitur transparencën, llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe mirëqeverisjen.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe trajnimit të gazetarëve dhe shoqërisë civile ku në bashkëpunim me organizatën Fakteo janë zhvilluar një sërë aktivitetesh trajnuese në Tiranë, Shijak dhe Korçë.

Në kuadër të “*Javës së integritetit*”, Zyra e Komisionerit së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, organizuan një forum diskutimi në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në këtë takim, të pranishmit u njohën me rolin dhe funksionet e koordinatorit kombëtar kundër korrupsionit, si dhe me kuadrin ligjor që garanton transparencën e autoriteteve publike dhe ushtrimin e të drejtës për informim nga qytetarët. Në takimet e realizuara janë trajtuar çështje të ndryshme mbi ecurinë e planit strategjik të ICIC dhe është raportuar mbi punën e 4 grupeve të punës, ku Zyra e Komisionerit është pjesë e “Grupit Ndërkombëtar të Punës mbi Transparencën Proaktive dhe Grupin Ndërkombëtar të Punës mbi Trajnimet”.

## **MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

### **➤ Nënprodukti C: Mbikëqyrje dhe inspektime, i ndryshuar, (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +-50),**

Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2023 realizoi 47 hetime administrative në terren. Nga këto, 32 me iniciativën e Zyrës së Komisionerit dhe 15 hetime janë zhvilluar për verifikimin e ankesave të qytetarëve. 9 procedura hetimi administrativ janë kryer në kontrollues publik dhe 38 të tjera, në kontrollues privat, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Synimi kryesor i hetimeve administrative ka qenë zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

### **➤ Rekomandime/Vendime gjore /sanksione administrative/urdhra/Seanca dëgjimore**

Nëpërmjet akteve të Komisionerit është synuar të ndërgjegjësohet çdo kontrollues/përpunues i të dhënave për të kryer përpunime në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pa cenuar privatësinë e individit.

Gjatë vitit 2023, në lidhje me 47 hetimet administrative të kryera, Komisioneri është shprehur me:

- 21 Rekomandime;
- 1 Urdhër në kontrollues privat për fshirjen e të dhënave personale
- 19 Vendime, të cilat korrespondojnë me 64 sanksione administrative.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, për qartësimin e rrethanave dhe fakteve në lidhje me proceset administrative të kryera, u zhvilluan në total 37 seanca dëgjimore.

### **➤ Dhënie mendimi për projektligje/projektvendime/Opinione ligjore**

Zyra e Komisionerit ka dhënë mendime ligjore për;

- 9 projekt-vendim;

- **10** projekt-ligje;
- **30** opinione ligjore të paraqitura nga kontrollues publik e privat.

➤ **Transferimi ndërkombëtar**

Objektiv i Zyrës së Komisionerit është edhe garantimi i përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm i të dhënave personale të individëve në rastet kur këto të dhëna përpunohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra e Komisionerit trajtoi 12 praktika për autorizimin e transferimit në disa shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, kryesisht në sektorin bankar. Në këto raste, praktikat janë shqyrtuar në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe akteve nënligjore për transferimin ndërkombëtar si dhe kontrolluesit janë orientuar dhe udhëzuar me qëllim zbatimin sa më të drejtë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

➤ **Njoftimi/regjistrimi i kontrolluesve**

Në përmbushje të detyrimit ligjor për të njoftuar, kanë njoftuar **59** subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri tani ka arritur në **5.944**

**Nënprodukti C: (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +- 50), janë realizuar 47, pa përfshirë veprime të tjera vendime, rekomandime, sanksione, urdhërime duke realizuar rreth 94 % të numrit të planifikuar**

**-Nënprodukti D. Ankesa të trajtuara ( nr.rreth +- 300),**

Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit ka administruar dhe trajtuar 394 ankesa nga qytetarët në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, e cila tregon një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve në cilësinë e subjektit të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave që garanton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, të drejtës për t'u ankuar. Tendenca në rritje e numrit të ankesave gjatë viteve të fundit, është tregues për rëndësinë që po i kushtojnë individët kontrollit dhe mbrojtjes së të dhënave të tyre personale.

**Nënprodukti D: Ankesa të trajtuara, pa përfshirë vendime, rekomandime është realizuar nga ana sasiore 394 ankesa, nga 300 të planifikuara .**

❖ **Aktivitete të tjera mbështetëse**

Me rastin e 28 Janarit, Ditës Ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit zhvilluan një takim në formën e një leksioni të hapur. Të pranishëm ishin studentë dhe staf akademik e administrativ nga ky institucion i arsimit të lartë (IAL) jo publik.

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm, me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, në kuadër të projektit “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave” organizuan :

- ✓ aktivitete me fokus institucionet e arsimit të lartë (IAL), ku morën pjesë studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës;
- ✓ tryezën e rumbullakët me tematikë “Epoka digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale brenda sektorit bankar”;
- ✓ aktivitetin me përfaqësues nga subjekte fizike/tregtare që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e pasurive të paluajtshme;
- ✓ aktivitetin me përfaqësues të medias;
- ✓ aktivitetin me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- ✓ aktivitete me dy shkolla të arsimit parauniversitar.

Në të gjitha këto aktivitete, u theksua qasja ndërgjegjësuese, si një nga mënyrat efikase për forcimin e kulturës së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve si dhe u njohën me ristë e GDPR, reflektuar në projektligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

-Në kuadër të bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), u zhvilluan takime njohëse për zbatimin e legjislacionit në të dy këto fusha në qytetin e Gjirokastrës, Bashkisë së Malësisë së Madhe dhe Bashkisë Kavajë. Në këto aktivitete u trajtuan elemente të ndryshme të kuadrit rregullator si në fushën e të drejtës për informim dhe në atë për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mbi veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, një vëmëndje e posaçme iu kushtua risive që do të sjell legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, që transpozon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), ashtu si dhe ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Zyra e Komisionerit është përfaqësuar në aktivitetin e Qendrës “*Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)*” e cila zbatoi projektin “*Festivali Kombëtar i të Drejtave Digjitale*”. Synimi i këtij aktiviteti ishte informimi i organizatave lokale të shoqërisë civile për të adresuar çështjet e të drejtave digjitale dhe sigurisë kibernetike, fuqizimi i të rinjve shqiptarë mbi mbrojtjen nga rreziqet e internetit dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre digjitale, se si t’i praktikojnë dhe mbrojnë ato.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përfaqësuar në aktivitete dhe panairë “Festivali i Inovacionit - InnFest 2023” në apo edicioni i 29-të të “Panairit Ndërkombëtar të Tiranës”. Në fokus ishte informimi dhe njohja me kuadrin rregullator në fuqi në këtë fushë, roli dhe veprimtaria mbikëqyrëse e institucionit dhe ecuria e procesit të përafrimit të plotë të GDPR në legjislacionin kombëtar. Këto aktivitete kanë shërbyer si një platformë informimi, komunikimi dhe nxitje e bashkëpunimit mes qytetarëve, institucioneve publike/shtetërore dhe komunitetit të biznesit, për ofrimin e shërbimeve inovatore dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

Një tjetër aktivitet që mbështet të dy shtyllat për garantimin e dy të drejtave **është Shërbimi ligjor**, edhe pse në vitet e kaluara janë trajtuar si produkt më vete.

➤ **Hartimi i dokumenteve**

- Është hartuar Raporti Vjetor 2022, mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Kuvendit;
- Është hartuar Programi i Punës për vitin 2023 i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Është hartuar dhe botuar Udhëzues “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”;
- Është punuar mbi ndryshimet për rregulloren e brendshme të Zyrës së Komisionerit.
- Është punuar mbi komentet e projektligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale*

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përafuar me Rregulloren e BE-së 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 të BE-së, vijon të jetë në fazën e finalizimit të miratimit të tij. Për shkak të rëndësisë që mbart ky projektligj si një ligj parakusht për integrimin e vendit, ka qënë i domosdoshëm edhe kontributi i Komisionit Evropian. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 u zhvilluan një sërë takimesh të përbashkëta midis ekspertëve të Komisionit Evropian, Delegacionit të BE-së në Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më tej “Zyra e Komisionerit”) me qëllim diskutimin dhe dakortësinë e komenteve të Komisionit Evropian. Ndërkohë Zyra e Komisionerit vijon të ketë një rol aktiv në këtë proces pasi vlerëson se miratimi sa më shpejt i këtij projektligji është një domosdoshmëri.

*Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

- Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë organizuan takime konsultative me grupet e interesit dhe institucionet publike mbi propozimet e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe morën pjesë aktive në Komisionet e përhershme të Kuvendit, mbi miratimin e këtyre propozimeve. Në 21 shtator 2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Këto ndryshime përmirësojnë legjislacionin e kësaj fushe dhe kanë si synim forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Gjithashtu, ndryshimet mbajnë në konsideratë edhe standardet e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa 205 e Tromsos), të miratuar vitin e kaluar nga Kuvendi. Gjithashtu ka iniciuar në koordinim me strukturat përgjegjëse procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, i ndryshuar.

➤ **Raportime**

Është plotësuar pyetësor “Mbi masat legjislative dhe masat e tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për qasjen në dokumentet zyrtare (Cets nr. 205) – Konventa Tromsø” dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Është raportuar në kuadër të Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2023 - 2025 dhe matricës përkatëse, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.

Është marrë pjesë në takimet e punë në 4 Grupe Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) në kuadër të hartimit të Udhërrëfyesit për shtetin e të drejtës si dhe udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike.

Është dhënë informacion mbi përditësimin e Raportit të vlerësimit të Shqipërisë për ciklin e dytë të rishikimit të UNCAC (*United Nations Convention against Corruption*), dërguar nga Ministria e Drejtësisë.

Është plotësuar “Pyetësori i rregullimit të të dhënave të dhënat globale të Bankës Botërore”.

Është raportuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të publikimit të Raportit Screening, të Komisionit Evropian, për Grupimin e Parë “Themeloret” për nënkapitullin e të drejtave themelore, duke dërguar masat konkrete të propozuar nga Zyra e Komisionerit.

Është raportuar në kuadër të kontributit Simestrit II dhe II për Progres Raportit dhe integrimin evropian si dhe raportime periodike për Road Map-in e hartuar nga Ministria e Drejtësisë.

Është përgatitur Prezantimin PPT “Mbi të dhënat e hapura dhe informacionin e sektorit publik” pjesë e Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe media” mbajtur në kuadër të takimit bilateral në mars 2023 në Bruksel.

Është raportuar në kuadër të Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Vendimit nr.134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik” mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Zyra e Komisionerit, për autoritetet publike si dhe statusin e zbatueshmërisë së tyre

Është raportuar mbi hartimin dhe objektivat për t’u parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit 2023-2030.

Është dhënë mendim për Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.

Është raportuar në kuadër të zbatimit të “Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026”.

Sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare për periudhën e raportuar Zyra e Komisionerit është anëtarësuar në disa grupe pune. Paralelisht, është bashkëpunuar me institucione/organizma vendore dhe për krijimin e një mjedisi për njohjen dhe ushtirimin e të drejtave të qytetarëve.

Më gjerësisht, në faqen zyrtare [www.idp.al](http://www.idp.al), keni të publikuar të gjithë aktivitetin/tet e Zyrës së Komisionerit

## **-Të ardhurat nga sanksionet/gjoha**

Për periudhën raportuese, për Zyrën e Komisionerit, janë arkëtuar 1.310.000 lekë, nga të cilat 810.000 lekë janë arkëtimet për vitin 2023. Pjesa tjetër i takon detyrimeve të prapambetura në vite.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**